



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1125/3 prot.

Tiranë më 05.06.2025

V E N D I M

Nr. 15, datë 05.06.2025

PËR LEJIMIN E TRANSFERIMIT NDËRKOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 41 dhe germës “e”, të pikës 1 të nenit 82 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të kërkesës administruar me nr. 1125 prot., datë 12.05.2025, për pajisje me autorizim për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale transferuesi “Banka Kombëtare Tregtare SHA”, tek marrësi “Dandelion Payments, Inc. Db a Ria Money Transfer” i vendosur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (në vijim, “SHBA”).

KONSTATOVA SE:

Subjekti kontrollues “Banka Kombëtare Tregtare SHA” ka kërkuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), pajisjen me autorizim për transferimin e të dhënave personale tek marrësi “Dandelion Payments, Inc. Db a Ria Money Transfer”, i vendosur në SHBA.

Sipas deklarimeve të subjektit në Formularin e Aplikimit, për aprovimin e transferimit të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, administruar pranë Zyrës së Komisionerit, transferimi që kërkohet të autorizohet nga Komisioneri përmban elementët e mëposhtëm:

1. Shteti ku do të realizohet transferimi: California, SHBA.
2. Kategoria e subjekteve të të dhënave objekt i transferimit:
 - Punëmarrës;
 - Klientë;

- Të tjera: Walkin Customers (klientë rastësor që nuk kanë llogari në BKT por kryejnë veprime/pagesa për palë të treta).

3. Kategoria e të dhënave objekt transferimi:

- Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja);
- Numri personal i identifikimit;
- Të tjera: adresa e banimit ose biznesit, adresa elektronike (email), numrat e telefonit ose faksit dhe çdo informacion tjetër kontakti, fotot, nënshkrimi, të dhënat e pasaportës/vizës/kartës së identifikimit; të dhënat financiare si dhe emrat dhe të dhënat personale të përfituesve të transfertave të parave, si dhe çdo të dhënë shtesë që mund të kërkohet nga organet ligjzbatuese në zbatim të kuadrit ligjor për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe veprimtarive të tjera kriminale.

4. Frekuenca e transferimit është:

- Vazhdimisht:
 - ❖ Sa herë e nevojshme.

5. Lidhur me qëllimin i transferimit, deklarohet se: *“Qëllimi është ofrimi i shërbimeve të transfertës ndërkombëtare të parave për klientët e BKT Albania, nëpërmjet integritit të sistemit të RIA Money Transfer. Të dhënat personale të klientëve të BKT do të përpunohen nga RIA për të kryer në kohë reale transaksione të dërgesës apo marrjes së fondeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative për përpunimin e pagesave, identifikimin e klientit (KYC), dhe parandalimin e pastrimit të parave (AML)”*.

6. Ndërkohë, në Rubrikën 7 të Formularit të Aplikimit, rrethanat lidhur me përpunimin e subjektit transferues, ka deklaruar: *“Përpunimi i të dhënave brenda qëllimit të ekzekutimit të kësaj kontrate është e lidhur ngushtësisht me realizimin e pagesave ndërkufitare. Në këtë këndvështrim përpunimi nëpërmjet sistemeve softuerike (RIA Online Processing System), nënkupton: mbledhje, regjistrim, organizim, strukturim të të dhënave, ruajtje përshtatje ose ndryshim të tyre për qëllime të ekzekutimit të transfertave apo veprimeve ndërkufitare apo veprime rakordimi me Dandelion Payments, si dhe përafrimin ose kombinimin, kufizimin, fshirjen ose shkatërrimin e të dhënave gjatë proceseve të punës ose edhe në kontekstin e përfundimit të kontratës me përpunuesin.*

Palët impenjohen të marrin masa teknike dhe organizative të tilla që të garantohet transferimi dhe përpunimi i sigurt i të dhënave. Të gjitha të dhënat personale janë të koduara në ruajtje dhe në transmetim, duke përdorur protokolle të kodimit të standardit të industrisë”.

7. Në lidhje me Rubrikën 8, natyra e përpunimit dhe kohëzgjatja e tij, citohet se: *“Përpunimi do të ketë natyrë ekzekutuese lidhur ngushtësisht me realizimin e shërbimit të pagesave ndërkufitare. Të dhënat personale do të përpunohen për kohëzgjatjen që kërkohet për realizimin e shërbimit të transfertës së parave dhe për mbajtjen e gjurmëve të transaksioneve në përputhje me kërkesat ligjore për ruajtjen e të dhënave financiare dhe për qëllime të auditimit dhe raportimit. Konform kontratës me RIA, të dhënat ruhen vetëm për aq kohë sa kërkohet nga rregulloret përkatëse dhe më pas fshihen ose anonimizohet, sipas politikave të tyre të privatësisë dhe sigurisë”.*

8. Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave, citojmë: *“Të dhënat personale që transferohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të ruhen për një periudhë kohore që përputhet me kërkesat ligjore dhe rregullatore të vlefshme për sektorin financiar, përfshirë detyrimet për ruajtjen e të dhënave për qëllime auditimi, parandalimit të pastrimit të parave dhe raportimi rregullator.*

Pas përfundimit të marrëdhënies kontraktuale, të dhënat personale fshihen, shkatërrohen, në përputhje me politikat e sigurisë së informacionit të përpunuesit dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, brenda një periudhe prej jo më shumë se 180 ditësh nga data e ndërprerjes së marrëveshjes”.

Në bazë të Vendimit nr. 01, datë 30.04.2025 të Komisionerit *“Për përcaktimin e shteteve që sigurojnë një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”*, SHBA nuk përfshihet në listën e vendeve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.

Në zbatim të nenit 41 të Ligjit, në rastet kur mungon një vendim përshtatshmërie sipas nenit 40 të Ligjit, kontrolluesi *“Banka Kombëtare Tregtare SHA”* duhet të marrë autorizim paraprak nga Komisioneri, përpara kryerjes së transferimit të të dhënave personale drejt një vendi të tretë pa nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.

Për këtë qëllim, kontrolluesi përveç Formularit të Aplikimit për aprovimin e transferimit të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, ka depozituar edhe një sërë dokumentesh në mbështetje të kërkesës së tij, për të legjitimuar transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale në marrësin e sipërcituar dhe konkretisht:

- Marrëveshje ndërkombëtare për transferimin e parave;
- Shtojca D – Marrëveshje për mbrojtjen e të dhënave;
- Manuali i procedurave operative;
- Shtojca A – Masat e Sigurisë;
- Termat dhe Kushtet e Shërbimit;
- Ria Money Transfer në BKT Smart.

Në mbështetje të dokumentacionit të paraqitur nga Kontrolluesi dhe analizimit të përmbajtjes së tyre rezulton se ky transferim të dhënash personale është në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale, sipas akteve ndërkombëtare dhe vendase, dispozitat e Ligjit, si dhe me Udhëzimin nr. 41, datë 13.06.2014 të Komisionerit “Për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

http://www.idp.al/images/Legjislacion/udhezime/udhezim_nr_42_date_22_korrik_2014.pdf
http://www.idp.al/images/Legjislacion/udhezime/udhezimi_nr_41_13062014.pdf

Sa më sipër, kërkesa për marrjen e autorizimit nga Komisioneri për transferimin e të dhënave personale nga kontrolluesi “Banka Kombëtare Tregtare SHA”, plotëson kërkesat ligjore për t’u pajisur me Autorizim për transferimin e të dhënave personale të kërkuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 41 dhe germës “e”, të pikës 1 të nenit 82 të Ligjit:

V E N D O S A :

1. Lejimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale nga kontrolluesi “Banka Kombëtare Tregtare SHA”, duke përcaktuar si më poshtë:

Kontrolluesi “Banka Kombëtare Tregtare SHA” lejohet të transferojë tek marrësi i të dhënave “Dandelion Payments, Inc. Db a Ria Money Transfer”, i vendosur në SHBA, kategorinë e të dhënave personale “Punëmarrës, Klientë dhe Walkin Customers”, si më poshtë:

- Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja);
- Numri personal i identifikimit;
- Të tjera: adresa e banimit ose biznesit, adresa elektronike (email), numrat e telefonit ose faksit dhe çdo informacion tjetër kontakti, fotot, nënshkrimi, të dhënat e pasaportës/vizës/kartës së identifikimit; të dhënat financiare si dhe emrat dhe të dhënat personale të përfituesve të transfertave të parave, si dhe çdo të dhënë shtesë që mund të kërkohet nga organet ligjzbatuese në zbatim të kuadrit ligjor për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe veprimtarive të tjera kriminale.

Të dhënat e cituara më sipër do të transferohen vetëm për qëllimin e deklaruar nga transferuesi në Formularin e Aplikimit për autorizim mbi transferimin e të dhënave personale, e cila ka të bëjë me “Ofrimin e shërbimeve të transfertës ndërkombëtare të parave për klientët e BKT Albania, nëpërmjet integritit të sistemit të RIA Money Transfer”.

2. Të dhënat personale të lejuara për t'u transferuar (parashikuar në pikën 1), do të ruhen jo më shumë se 180 ditë nga data e ndërprerjes së marrëveshjes midis transferuesit dhe marrësit të të dhënave.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot më datë 05.06.2025

KOMISIONERI

Besnik Dervishi